



ГРАДЕЊЕ НА УСЛУГИ ZASNOVANI NA ZAEДНИЦАТА
ЗА ПОДДРШКА NA PECOИЈАЛИЗАЦИЈА И
РЕИНТЕГРАЦИЈА NA ПОРАНЕШНО ОСУДЕНИ ЛИЦА

MONITORIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË PËR ZHVILLIMIN E SHËRBIMIT TË PROBACIONIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT (2021-2025)

Periudha e monitorimit:
viti 2021 dhe 2022



Наслов на оригиналот:

МОНИТОРИНГ НА СПРОВЕДУВАЊЕ НА СТРАТЕГИЈАТА НА РАЗВОЈ НА ПРОБАЦИСКА СЛУЖБА ВО РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА (2022-2025)

Период на следење: 2021 и 2023

Titulli i originalit:

MONITORIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË PËR ZHVILLIMIN E SHËRBIMIT TË PROBACIONIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT (2021 – 2025)

Periudha e monitorimit: viti 2021 dhe 2022

Botues:

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut

Përfaqësuar nga:

Prof. Dr. Neda Zdraveva

Autore:

Aleksandra Trajanovska

Redaktore:

Tona Kareva Taleska

Përkthimi në shqip:

Shenasi Jaji

Lektore:

Violeta Tanceva-Zlateva

Viti i botimit:

2023

Vendi i botimit:

Shkup

Numri i faqeve:

41

Dizajni grafik:

Masiva Creative Agency

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

343.265.2:354.51.075.5]:005.21(497.7)"2021/2025"(047.31)

343.24/.26(497.7)(047.31)

TRAJANOVSKA, Aleksandra

Monitorimi i zbatimit të strategjisë për zhvillimin e shërbimit të probacionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut [Електронски извор] : (2021-2025) : periudha e monitorimit viti 2021 dhe 2022 / [author Aleksandra Trajanovska ; përkthimi në shqip Shenasi Jaji]. - Skopje : Helsinki committee for human rights, 2023

Начин на пристапување (URL):

<https://mhc.org.mk/sq/publicationsanalyzes-sq/monitorimi-i-zbatimit-te-strategjise-per-zhvillimin-e-sherbimit-te-probacionit-ne-republiken-e-maqedonise-se-veriut-2021-2025/>.

- Текст во ПДФ формат, содржи 38 стр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 28.09.2023. - Превод на делото: Мониторинг на спроведувањето на стратегијата за развој на пробациска служба во Република Северна Македонија : [2021-2025] : период на следење 2021 и 2022 / Александра Трајановска

ISBN 978-608-4977-18-6

а) Пробациска служба -- Стратегија за развој, 2021-2025 --

Спроведување

-- Македонија -- Истражувања б) Алтернативни мерки и санкции --

Македонија -- Истражувања

COBISS.MK-ID 61727237



МЗМП



Ky publikim është prodhuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e MZMP dhe Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

PËRMBAJTJA

LIST OF ABBREVIATIONS USED	5
HYRJE	6
RRETH PROJEKTIT	8
METHODOLOGJIA	10
GJETJET NGA MONITORIMI	13
Legjislacioni – Korniza ligjore në fushën e ekzekutimit të sanksioneve dhe masave alternative	13
Rezultati 1.1. Analiza mbi nevojën për ndryshime në kornizën ligjore për të mbështetur shërbimin e probacionit dhe sanksionet alternative	13
Rezultati 1.2. Ndryshimet në kornizën ligjore për të rritur numrin e sanksioneve dhe masave alternative të shqiptuara	14
Rezultati 1.2.1. Të zgjerohet zbatueshmëria e punës së dobishme në komunitet në Kodin Penal	14
Rezultati 1.2.2. Përdorimi më i madh i sanksioneve alternative në Ligjin e Procedurës.Penale.....	15
Rezultati 1.2.3. Të zgjatet periudha nën mbikëqyrje dhe mbështetja për personat në lirim me kusht nga ana e shërbimit të probacionit	15
Rezultati 1.3. Ndryshime në kornizën ligjore për të mbështetur shërbimin e probacionit	16
Rezultati 1.4. Aktet nënligjore të plota dhe të përditësuara për zbatimin praktik të sanksioneve alternative dhe funksionimin e shërbimit të probacionit	16
Rezultati 1.5. Analiza e nevojave për ndryshime në kornizën ligjore dhe procedurat e punës për të mbështetur shërbimin e probacionit dhe sanksionet alternative në rastet e drejtësisë për personat e mitur.....	16
Korniza institucionale për funksionimin e shërbimit të probacionit – zyrat funksionale	18
Rezultati 2.1. Në funksion janë 15 zyra probacioni dhe mbulojnë çështjet e probacionit për rajonet e të gjitha gjykatave	18
Rezultati 2.2. Zhvillimi i mëtejshëm i procedurave standarde të punës në shërbimin e probacionit	18
Rezultati 3.1. Rritja e numrit të profesionistëve të punësuar në sektorin e probacionit në nivel qendror dhe vendor	19
Rezultati 3.2. Krijimi i një qendre trajnimi dhe një buxheti për trajnimin e shërbimit të probacionit dhe për bashkëpunim me qendrat dhe akademitë e tjera përkatëse të trajnimit	19

Rezultati 3.3. Zhvillimi i një plani vjetor trajnimi për oficerët e probacionit që përditësohet rregullisht.....	20
Rezultati 3.4. Trajnimet e rregullta bazë do të zhvillohen për të gjithë oficerët e probacionit	20
Rezultati 3.5. Zhvillimi dhe përgatitja e trajnimeve speciale për lloje të veçanta klientësh	21
Rezultati 3.6. Trajtime të përbashkëta për krijimin dhe përmirësimin e bashkëpunimit të institucioneve përkatëse	21
Rezultati 3.7. Trajnimi i trajnuesve	22
Veprimi – Përmirësimi i procedurës dhe rritja e numrit të masave dhe sanksioneve alternative	23
Rezultati 1.2.4. Të rritet numri i sanksioneve alternative dhe të zvogëlohet numri i sanksioneve alternative të ankimuara	23
Rezultati 4.3. Rritja e numrit të aktgjykimeve për punë të dobishme në komunitet	23
Aktgjykime me sanksione alternative të shqiptuara në vitin 2021	27
Aktgjykime me sanksione alternative të shqiptuara në vitin 2022	28
Numri i rasteve të probacionit në vitin 2021 sipas llojit të masës së probacionit të shqiptuar 2021	29
Numri i rasteve të probacionit në vitin 2021 sipas llojit të masës së probacionit të shqiptuar 2022	29
Bashkëpunimi ndërinstitucional në fushën e probacionit	30
Rezultati 5.2. Mbajtja e tryezave të rregullta në nivel qendror dhe në të gjitha fushat me përfaqësues të autoriteteve gjyqësore dhe partnerët nga rrjeti i bashkëpunëtorëve	30
Rezultati 5.3. Protokollet e bashkëpunimit dhe listat e partnerëve të bashkëpunimit janë krijuar dhe përditësohen rregullisht	30
Rezultati 5.4. Përgatitja e mëtutjeshme e memorandumeve për bashkëpunim me komunat dhe ndërmarrjet tjera publike për kryerjen e punëve së dobishme në komunitet	31
Rezultati 5.5. Organizimi i tryezave të rregullta të shërbimit të probacionit dhe shërbimit të burgjeve në të gjitha fushat, në kuadër të institucioneve penitenciare dhe përcaktimi i procedurave standarde të punës për bashkëpunim me institucionet e vuajtjes së dënimit	32
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	33
LITERATURA E PËRDORUR	38
Shtojca 1 – Matrica e monitorimit	39

LISTA E SHKURTESAVE TË PËRDORURA

KP – KODI PENAL

LPP – LIGJI I PROCEDURËS PENALE

RMV – REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

DES – DREJTORIA PËR EKZEKUTIMIN E SANKSIONEVE

KGjRMV – KËSHILLI GJYQËSOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

PPRMV – PROKURORIA PUBLIKE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

OSHC – ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE

REKA – REGJISTRI ELEKTRONIK KOMBËTAR I AKTEVE TË RMV-së

PSO – PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE

HYRJE

Shërbimi i Probacionit (i provës) është një njësi organizative e veçantë e krijuar në kuadër të Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve pranë Ministrisë së Drejtësisë. Shërbimi ushtron mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve pa u privuar nga liria, më konkretisht mbi masat alternative: dënim me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, punë në dobi të përgjithshme dhe arrest shtëpiak, si dhe mbi ekzekutimin e lirit me kusht, të shqiptuara me vendim të gjykatës. Shërbimi i Probacionit mbikëqyr personat e dënuar dhe u ofron atyre mbështetje, kurse synimi është ruajtja e sigurisë në komunitet duke përmirësuar risocializimin dhe riintegrimin e personave mbi të cilët ekzekutohen punë probacioni, si dhe reduktimin e numrit të të burgosurve. Gjithashtu, shërbimi sprovues është përgjegjës për përgatitjen e raporteve për vlerësimin e rrezikut të personave të akuzuar gjatë procedurave gjyqësore me propozimin për llojin e sanksionit penal për të akuzuarin. Shërbimi i Probacionit është një pjesë thelbësore e sistemit modern të drejtësisë penale dhe synon të kontribuojë në uljen e mbipopullimit në sistemin e burgjeve, duke dhënë njëkohësisht dënimet e duhura për shkelësit, duke bërë që ata të ndryshojnë mënyrën e tyre të jetesës.

Në vitin 2021 është përgatitur Strategjia për Zhvillimin e Shërbimit të Probacionit në RMV 2021-2025 (në tekstin e mëtejme: Strategjia), e cila parasheh një gamë të gjerë të rezultateve që duhet të realizojnë disa institucione kompetente. Strategjia është një dokument strategjik gjithëpërfshirës që ofron një udhërrëfyes për reformat që duhet të bëhen në periudhën e ardhshme.

Qëllimi i kësaj analize është të shqyrtojë në mënyrë më të detajuar zbatimin e Strategjisë dhe të krijojë dhe zbatojë një sistem monitorimi të pavarur. Vetë probacioni, në fakt nënkupton vendosjen e një sistemi efikas të sanksioneve dhe mekanizmave mbrojtës që kontribuojnë në uljen e kriminalitetit, rritjen e mbrojtjes së shoqërisë dhe sigurisë publike, si dhe në risocializimin dhe riintegrimin e personave të dënuar.

Në periudhën 2021-2022, zbatimi i Strategjisë parashikon hartimin dhe miratimin e rregulloreve (ligje, ndryshime ligjore dhe akte të tjera), zbatimin e aktiviteteve specifike (p.sh. rritja e kapaciteteve njerëzore dhe teknike të shërbimit të probacionit, etj.), si dhe bashkëpunimi ndërinstucional në fushën e probacionit (mbajtjen e takimeve me institucionet relevante, takime tremujore etj.).

Me Planin e veprimit të Strategjisë për zhvillimin e shërbimit të probacionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përcaktohen aktivitetet në kuadër të secilit qëllim dhe rezultatet e përcaktuara me Strategjinë, kurse njëkohësisht përcaktohen edhe afatet kohore dhe treguesit për përmbushjen e tyre. Në këtë drejtim, qëllimi i kësaj analize është të vlerësojë nëse, në çfarë mase dhe në çfarë mënyre po bëhet zbatimi i Strategjisë për periudhën për të cilën është paraparë. Gjithashtu, analiza do të vlerësojë nëse rezultatet dhe aktivitetet janë zbatuar në kohën e duhur, në përputhje me kornizën kohore, cila është cilësia e tyre dhe dinamika dhe bashkëpunimi ndërinstytucional në fushën e probacionit. Nga ana tjetër, do të analizohet ndikimi i reformave në respektimin e të drejtave të njeriut, kështu që në përputhje me rezultatet e nxjerra nga monitorimi i Strategjisë, Analiza do të ofrojë edhe konkluzione dhe rekomandime për zhvillimin e mëtejshëm të shërbimit të probacionit.

Vëzhgimi, si sistem i pavarur i monitorimit, do të kontribuojë në një llogaridhënie më të madhe të institucioneve kompetente që janë përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve specifike të përcaktuara në Strategji.

RRETH PROJEKTIT

Ky dokument është përgatitur në kuadër të projektit “Ngritja e shërbimeve në komunitet për mbështetje nëpërmjet risocializimit dhe riintegrit të ish-të dënuarve”, financuar nga Bashkimi Evropian. Për qëllime të projektit është nënshkruar memorandum bashkëpunimi ndërmjet Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Shoqatës Maqedonase të Juristëve të Rinj, Shoqatës Penologjike Maqedonase, Shoqatës për këshillim, trajtim, riintegrim dhe risocializim të personave të varur nga substancat psikoaktive IZBOR dhe Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të zvogëlojë recidivizmin dhe cenueshmërinë e personave të dënuar pas lirimit të tyre, duke forcuar politikat dhe shërbimet për risocializimin, riintegrimin dhe kujdesin pas-penal të tyre në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare dhe evropiane.

Qëllimet specifike të cilat synon projekti:

- Të përmirësojë cilësinë dhe disponueshmërinë e shërbimeve për mbrojtje penale dhe post-kriminale me qëllim të risocializimit dhe riintegrit të personave të dënuar, të dënuar më parë, si dhe personave që janë në probacion;
- Të rritet kapaciteti dhe bashkëpunimi ndërinstytucional ndërmjet institucioneve penale, gjykatave, nëpunësve të probacionit, qendrave për punë sociale dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve për risocializim, probacion dhe mbrojtje pas-penale;
- Të përmirësohet korniza ligjore dhe politikat për risocializimin dhe riintegrimin e personave të dënuar, të dënuar më parë, si dhe të personave që i nënshtrohen probacionit në bazë të hulumtimeve dhe praktikave më të mira.

Objektivat e projektit do të arrihen përmes një grupi të ndërlidhur prej tre komponentësh:

- **Ofrimi i shërbimeve** që përfshin aktivitete për krijimin e një shërbimi kombëtar mbështetës për risocializimin dhe rehabilitimin e të burgosurve në partneritet midis OSHC-ve dhe DES-it, të cilët do të ofrojnë mbështetje para dhe pas lirimit

(mbështetje ligjore, psikosociale, mbështetje karriere dhe trajtim nga varësia). Nëpërmjet këtij komponenti, projekti do të pilotojë një program për lehtësimin e punësimit të ish-të burgosurve, në bashkëpunim me Agjencinë e Punësimit dhe sektorin e biznesit.

- Komponenti **Ngritja e Kapaciteteve dhe Rrjetëzimi** parashikon zhvillimin e kurrikulës dhe materialeve trajnuese, zbatimin e një programi trajnimi për gjyqtarët, këshilltarët e burgjeve, oficerët e probacionit, punonjësit socialë dhe ofruesit e shërbimeve, organizimin e seminareve rajonale për të përcaktuar kushtet për bashkëpunimin ndërinstitucional dhe krijimin dhe ofrimin e mbështetjes për tre ekipe lokale ndërinstitucionale për mbështetjen e koordinuar post-penale.
- Monitorimi i zhvillimit të shërbimit të probacionit në RMV 2021 – 2025 është pjesë e komponentit të tretë – **Korniza e Kërkimit dhe Politikave**, i cili gjithashtu do të mbështesë zhvillimin e dy PSO-ve, organizimin e konferencave dhe zhvillimin e dokumenteve të politikave.

METODOLOGJIA

Qëllimi i kësaj analize është të shqyrtojë më në detaje zbatimin e Strategjisë dhe të krijojë dhe zbatojë një sistem të pavarur monitorimi. Po ashtu, në atë drejtim, analiza do të vlerësojë nëse, në çfarë mase dhe në çfarë mënyre po bëhet zbatimi i Strategjisë për periudhën për të cilën është paraparë. Do të vlerësojë nëse rezultatet dhe aktivitetet janë realizuar në kohën e duhur, në përputhje me afatin kohor, cila është cilësia dhe dinamika e tyre dhe bashkëpunimi ndërinstytucional në fushën e probacionit. Nga ana tjetër, do të analizohet ndikimi i reformave në respektimin e të drejtave të njeriut, kështu që në përputhje me rezultatet e nxjerra nga monitorimi i Strategjisë do të nxirren konkluzionet kryesore se çfarë është zbatuar dhe çfarë ka munguar dhe cilat janë pengesat kryesore për të, si dhe do të ofrohen rekomandime për zbatimin e mëtejshëm të Strategjisë.

Fokusi i monitorimit janë katër tema, përkatësisht:

- Legjislacioni - Korniza ligjore në fushën e ekzekutimit të sanksioneve dhe masave alternative;
- Kuadri institucional – Kuadri institucional për funksionimin e shërbimit të provës – zyrat funksionale;
- Veprimi – Përmirësimi i veprimit dhe rritja e numrit të masave dhe sanksioneve alternative;
- Bashkëpunimi ndërinstytucional në fushën e probacionit.

Brenda këtyre katër elementeve, sipas një matrice të paracaktuar monitorimi (shtojca 1), subjekt i monitorimit do të jenë:

- Vlerësimi i zbatimit të rezultateve;
- Vlerësimi i zbatimit të aktiviteteve;
- Vlerësimi i dinamikës së zbatimit të aktiviteteve specifike;

- Vlerësimi i nivelit të përfshirjes së aktorëve kryesorë;
- Vlerësimi i cilësisë dhe përshtatshmërisë së aktiviteteve të zbatuara;
- Vlerësimi i ndikimit mbi të drejtat e njeriut për secilin aktivitet.

Monitorimi, si sistem i pavarur i monitorimit, do të kontribuojë në një llogaridhënie më të madhe të institucioneve kompetente që janë përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve specifike të përcaktuara në Strategji. Gjithashtu, monitorimi do të vlerësojë realizimin e rezultateve të pritshme të përcaktuara në Strategji dhe realizimin e aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit në lidhje me katër temat që janë objekt i monitorimit.

Monitorimi do të realizohet përmes nën-aktiviteteve të mëposhtme:

1. Mbledhja e të dhënave

Të dhënat do të mblidhen në disa mënyra, nëpërmjet:

- shqyrtimit dhe analizës së dokumenteve, strategjive, ligjeve, akteve nënligjore, raporteve nga fusha e probacionit;
- kërkesave për qasje të lirë në informacione të natyrës publike pranë institucioneve përkatëse (Drejtoria e Ekzekutimit të Sanksioneve, zyrat e probacionit, gjykatat);
- intervistave gjysmë të strukturuar dhe grupeve të synuara me oficerët e probacionit, gjyqtarët dhe personat nën probacion, Drejtorinë për Ekzekutimin e Sanksioneve, si dhe institucione të tjera përkatëse.

2. Njoftimi dhe publikimi

Si rezultat i monitorimit, do të përgatiten dhe publikohen gjashtë raporte, me një pasqyrë të gjetjeve kryesore të procesit të monitorimit. Nga raportet do të bëhen infografikë, për të paraqitur më lehtë të gjeturat nga monitorimi.

3. Promovimi i gjetjeve

Raportet do të ndahen me institucionet përkatëse dhe do të jenë të disponueshme publikisht në faqen e internetit të partnerëve të projektit.

4. Diskutim rreth gjetjeve

Gjetjet e secilit raport do t'u prezantohen aktorëve kryesorë në një tryezë të rrumbullakët diskutimi. Secili institucion do të ftohet për të dhënë komente mbi gjetjet e raportit. Ngjarjet do të sigurojnë që të gjitha institucionet përkatëse të jenë të vetëdijshme për shkallën e zbatimit të strategjisë, si dhe për problemet që mund të prekin reformat në sektorin e probacionit.

5. Reagim/Përfaqësim

Si përjashtim, nëse identifikohen gjetje të caktuara specifike që kërkojnë veprime urgjente dhe të menjëhershme, do të përgatiten njoftime për të gjitha institucionet përkatëse dhe do të ndërmerren aktivitete avokuese për të përcaktuar problemet.

Raporti i parë do të analizojë rezultatet dhe aktivitetet në lidhje me katër temat, d.m.th atë që ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë vitit 2021 dhe 2022. Plani i Veprimit i Strategjisë për Zhvillimin e Shërbimit të Probacionit në RMV përcakton aktivitetet brenda çdo qëllimi dhe rezultati të përcaktuar nga Strategjia, si dhe një kornizë kohore dhe tregues që Ministria e Drejtësisë, Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve, zyrat e Shërbimit të Probacionit dhe autoritetet e tjera gjyqësore duhet të zbatojnë në periudhën 2021-2022.

Në bazë të kësaj metodologjie të monitorimit do të përgatiten raporte të tjera. Çdo raport mund të ketë një seksion që trajton çështjet që lidhen me situatën aktuale nëse konsiderohet e nevojshme.

GJETJET NGA MONITORIMI

Legjislacioni – Korniza ligjore në fushën e ekzekutimit të sanksioneve dhe masave alternative

Rezultati 1.1. Analiza mbi nevojën për ndryshime në kornizën ligjore për të mbështetur shërbimin e probacionit dhe sanksionet alternative

Duke pasur parasysh se sanksionet alternative përdoren rrallë në praktikë, Strategjia parashikon formimin e një grupi pune për përgatitjen e një analize të detajuar që do të identifikojë ndryshimet e nevojshme në kornizën ligjore për të mbështetur shërbimin e probacionit dhe zbatimin më të gjerë të sanksioneve alternative. Një pjesë e pengesave të identifikuara tashmë në Strategji janë shtrirja e pamjaftueshme e përdorimit të punës së dobishme në komunitet (*për krimet për të cilat parashikohet qjobë ose dënim me burq deri në tre vjet, gjykata mund të vendosë masën me pëlqimin e autorit. të punës në komunitet në lirinë e tij, nëse krimi është kryer në rrethana lehtësuese dhe shkelësi nuk ka qenë i dënuar më parë*)¹ dhe periudhën e shkurtër që probacioni ka për të mbikëqyrë lirinë me kusht, i cili në praktikë jepet zakonisht vetëm 3 muaj para përfundimit të dënimit.²

Qëllimi i ndryshimeve ligjore është tejkalimi i mangësive të përcaktuara nga praktika e mëparshme e shërbimit të probacionit, me qëllim përmirësimin e efektivitetit të sistemit të probacionit dhe mekanizmave mbrojtës që do të pranohen nga anan e komunitetit. Gjatë periudhës së monitorimit të Strategjisë, po punohet për ndryshime dhe plotësime në Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve, Kodi Penal dhe Ligji për Procedurën Penale dhe pas miratimit të tyre do të bëhen ndryshime dhe plotësime në Ligjin për probacionin, i cili planifikohet të fillojë në vitin 2023.

Analiza e nevojave për ndryshime në kornizën ligjore në mbështetje të shërbimit të probacionit dhe sanksioneve alternative është bërë në kuadër të projektit "Mbështetja e BE-së për shtetin e së drejtës" pas mbajtjes së katër tryezave të rrumbullakëta me temën "Analiza e nevojave për ndryshime ligjore, për të cilën ka bërë raport. Shërbimi i Probacionit

¹ Kodi Penal – Tekst i pastruar ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 55, viti 2013).

² Strategjia për zhvillimin e shërbimit të probacionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2021 – 2025).

u ka bërë propozime grupeve punuese që punojnë për ndryshime dhe plotësime në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale dhe se është e nevojshme miratimi i ndryshimeve në ligjet sistemore dhe më pas harmonizimi i Ligjit për Probacionit me to.

Rezultati 1.2. Ndryshimet në kornizën ligjore për të rritur numrin e sanksioneve dhe masave alternative të shqiptuara

Në pjesën e zhvillimit të kuadrit ligjor në fushën e ekzekutimit të sanksioneve dhe masave alternative, Strategjia parashikon gjithashtu ndryshime dhe plotësime në Kodin Penal dhe Ligjin për Procedurën Penale, bazuar në analizat e bëra nga grupi punues i krijuar dhe nga lista e propozuar nga Projekti Twinning “Forcimi i sistemit penitenciar dhe zhvillimi i shërbimit të probacionit”, i cili ishte zbatuar në vitet 2018-2020 nga DES, dhe që i referohet listës së dhënë në vazhdim të tekstit (Rezultati 1.2.1; Rezultati 1.2.2; Rezultati 1.2.3).

Rezultati 1.2.1. Të zgjerohet zbatueshmëria e punës së dobishme në komunitet në Kodin Penal

Një nga synimet strategjike më të rëndësishme të Strategjisë është zgjerimi i zbatueshmërisë së punës në komunitet për krimet për të cilat parashikohet dënim me burg deri në 5 vjet, në vend të kushteve të mëparshme të gjobës ose dënimit me burg deri në tre vjet, dhe krimi të jetë kryer në rrethana lehtësuese, kurse autori i pa dënuar më parë - për të rritur mundësinë e përfshirjes së të kthyerve që përjashtohen automatikisht nga sanksionet alternative në këtë masë. Në periudhën e monitorimit (2021 - 2022) u punua për ndryshime dhe plotësime të Kodit Penal, me të cilat u propozua heqja e kushteve që personi të mos ishte dënuar dhe vepra të ishte kryer në rrethana lehtësuese, me qëllim zgjerimin e fushështirjes së zbatueshmërisë së punës së dobishme në komunitet.

Gjithashtu, si propozim ndryshim i Kodit Penal, Sektori i Probacionit ka propozuar një nen të ri për vlerësimin e rrezikut të të akuzuarve në procedurat gjyqësore, i cili rregullohet me Ligjin për Probacion.

Prandaj, duam të theksojmë se ky rezultat i Strategjisë është përmbushur pjesërisht në periudhën e monitorimit 2021 - 2022.

Rezultati 1.2.2. Përdorimi më i madh i sanksioneve alternative në Ligjin e Procedurës Penale

Strategjia gjithashtu parasheh ndryshime dhe harmonizim të Ligjit për procedurë penale me Kodin Penal, me qëllim të harmonizimit të dy ligjeve në fushën e përdorimit të sanksioneve dhe masave alternative. Ministria e Drejtësisë krijoi në vitin 2021 një grup pune për të punuar për ndryshimet dhe rregullimet e Kodit Penal, i cili ndër të tjera i referohet dispozitave të nenit 43 – Shtyrja me kusht e ndjekjes penale dhe nenit 44 – Mosndërmarrja e ndjekjes penale, e gjithë kjo për të zgjeruar zbatueshmërinë për veprat penale për të cilat parashikohet një dënim me burg deri në 5 vjet.

DES i propozoi grupit të punës këto ndryshime ligjore në Ligjin për Procedurën Penale: në nenin 497, në seksionin për kushtet e dhënies së urdhrit penal, sanksioneve dhe masave penale tashmë ekzistuese t'u shtohen masat alternative: dënimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse dhe puna e dobishme në komunitet. Ndryshime janë propozuar edhe në nenin 506 – Shqiptimi i masave alternative, në të cilin do të shtohet edhe masa alternative e dënimit me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse. Në Projektligjin për procedurë penale, të publikuar në REKA në vitin 2022, në lidhje me nenin 506 - caktimi i masës alternative, parashihet që prokurori publik të mund t'i paraqesë gjykatës propozim prokurorial me propozim për caktimin e masës alternative, pas së cilës vepron në përputhje me dispozitat e urdhërit penal të këtij ligji.³

Rezultati 1.2.3. Të zgjatet periudha nën mbikëqyrje dhe mbështetja për personat në lirim me kusht nga ana e shërbimit të probacionit

Lirimi me kusht është lirimi i parakohshëm i një të dënuari nga vuajtja e dënimit me burg, i cili ka plotësuar disa kushte në përputhje me Kodin Penal. Praktika tregon se në shumicën e rasteve afati kohor prej 3 muajsh është shumë i shkurtër që shërbimi i probacionit të jetë në gjendje të ofrojë mbështetje dhe mbikëqyrje efektive ndaj personave të liruar me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse. Për këtë qëllim, Strategjia parashikon ndryshime në Kodin Penal që do të sigurojnë një periudhë më të gjatë të mbështetjes dhe mbikëqyrjes së shërbimit të probacionit, me qëllim uljen e rrezikut të recidivizmit dhe zbatimin e mbështetjes efektive për risocializimin e suksesshëm të personave të dënuar.

³ Projektligji për procedurën penale (versioni i punës 03.11.2022).
<https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=76038>

Rezultati 1.3. Ndryshime në kornizën ligjore për të mbështetur shërbimin e probacionit

Në përputhje me Strategjinë janë parashikuar ndryshime në kornizën ligjore për të mbështetur shërbimin e probacionit, për të kapërcyer mangësitë e përcaktuara nga praktika e mëparshme, për të përmirësuar efektivitetin e sistemit të probacionit dhe mekanizmat mbrojtës që do të pranohen nga komuniteti. Duke marrë parasysh se gjatë periudhës së monitorimit të Strategjisë 2021-2022 është duke u punuar për ndryshime dhe plotësime në Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve, deri në miratimin e tyre, nuk do të kalohet në ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për Probacion, të cilat ishin planifikuar për vitin 2023.

Prandaj, duam të theksojmë se ky rezultat i Strategjisë nuk është përmbushur në periudhën e monitorimit, respektivisht në vitin 2021 dhe 2022.

Rezultati 1.4. Aktet nënligjore të plota dhe të përditësuara për zbatimin praktik të sanksioneve alternative dhe funksionimin e shërbimit të probacionit

Meqenëse ndryshimet ligjore në mbështetje të shërbimit të probacionit nuk janë bërë ende gjatë periudhës së monitorimit, aktivitetet e parashikuara nga Strategjia për hartimin e akteve nënligjore të reja dhe të përditësuara për zbatimin praktik të sanksioneve alternative dhe funksionimin e shërbimit të probacionit nuk janë zbatuar ende.

Rezultati 1.5. Analiza e nevojave për ndryshime në kornizën ligjore dhe procedurat e punës për të mbështetur shërbimin e probacionit dhe sanksionet alternative në rastet e drejtësisë për personat e mitur

Shërbimi i Probacionit, në pajtim me Ligjin për Probacion, është kompetent të merret vetëm me kryesit e moshës madhore të veprave penale, andaj në këtë drejtim Strategjia parasheh një analizë se kur dhe si ky shërbim mund të jetë kompetent dhe të punojë në rastet e drejtësisë për të mitur. Gjatë periudhës së monitorimit të Strategjisë, aktivitetet dhe rezultatet për analizën e nevojave për një shërbim të specializuar të probacionit për drejtësinë për të miturit janë vënë në pritje/shtyrë për faktin se është e nevojshme të forcohet fillimisht pozita e shërbimit të probacionit brenda sistemit penitenciar dhe më pas kalohet në analizën e nevojave për shërbimin e probacionit në drejtësinë për të mitur. Për të bërë një analizë të suksesshme të nevojave të ndryshimit të kuadrit ligjor dhe

procedurave të punës në mbështetje të shërbimit të probacionit dhe sanksioneve alternative në drejtësinë për të miturit, është e nevojshme përfshirja e organizatave ndërkombëtare që punojnë në vendin tonë në fushën e të drejtave të njeriut, të drejtat e fëmijëve, shteti i së drejtës, sistemi penitenciar etj.

Prandaj, duam të theksojmë se ky rezultat i Strategjisë nuk është përmbushur në periudhën e monitorimit 2021-2022.

Korniza institucionale për funksionimin e shërbimit të probacionit zyrat funksionale

Rezultati 2.1. Në funksion janë 15 zyra probacioni dhe mbulojnë çështjet e probacionit për rajonet e të gjitha gjykatave

Korniza aktuale ligjore, së bashku me Strategjinë, parashikojnë hapjen e zyrave të mbetura të probacionit që do të mbulojnë zonat e të gjitha gjykatave. Deri në vitin 2022 janë themeluar dhe janë funksionale gjithsej 11 zyra probacioni, përkatësisht gjatë periudhës së monitorimit të Strategjisë zyrat e probacionit në Kavadar dhe Gjevgjeli janë themeluar në vitin 2021.

Zyra e parë e probacionit është hapur në vitin 2017 për zonën e Gjykatës Themelore Penale Shkup, ndërsa në vitin 2018 janë themeluar edhe 8 zyra të tjera: në Tetovë, Kumanovë, Veles, Shtip, Strumicë, Prilep, Ohër dhe Manastir, d.m.th. në gjykatat themelore me kompetencë të zgjeruar në përputhje me ndryshimet e fundit ligjore nga Ligji për Gjykatat. Rritja e numrit të rasteve të probacionit (në vitin 2021 ishte 451, ndërsa në vitin 2022 ishte 475) është një faktor kyç për hapjen e mëtejshme të zyrave të mbetura të probacionit, si dhe për rritjen e buxhetit të Drejtorisë për Ekzekutimin e Sankcioneve – Sektori i Probacionit.

Rezultati 2.2. Zhvillimi i mëtejshëm i procedurave standarde të punës në shërbimin e probacionit

Zhvillimi i mëtejshëm i procedurave standarde të punës është i rëndësishëm për të ardhmen e shërbimit të probacionit dhe për menaxhimin cilësor dhe të suksesshëm të rasteve të probacionit nga oficerët e probacionit. Duke marrë parasysh se ende nuk kanë filluar ndryshimet në Ligjin për Probacion, përmbushja e këtij rezultati të Strategjisë ende nuk është zbatuar. Për t'iu qasur zhvillimit të procedurave standarde të punës, është e nevojshme që fillimisht të hyjnë në fuqi ndryshimet në Ligjin për Ekzekutimin e Sankcioneve dhe Ligjin për Probacion.

Rezultati 3.1. Rritja e numrit të profesionistëve të punësuar në sektorin e probacionit në nivel qendror dhe vendor

Për të zhvilluar më tej shërbimin e probacionit, Strategjia parashikon rritjen e numrit të profesionistëve të punësuar në sektorin e probacionit. Në përputhje me metodologjinë e punësimit, në periudhën 2021-2025 duhet të punësohen gjithsej 90 oficerë probacioni.

ZYRA E PROBACIONIT	BASHKËPUNËTORË TË LARTË	BASHKËPUNËTORË TË RINJ
Sektori i probacionit në DES	2	1
Shkup	1	8
Kumanovë	/	3
Manastir	/	2
Strumicë	1	/
Shtip	/	2
Ohër	/	1
Veles	/	1
Prilep	/	2
Kavadar	/	1
Gjevgjeli	/	/
Tetovë	/	3
GJITHSEJ	4	24

*Në zyrën e probacionit në Gjevgjeli nuk ka asnjë punonjës të punësuar dhe rastet në atë zonë i trajton zyra e probacionit nga Strumica.

Ndaj, duam të theksojmë se ky rezultat i Strategjisë është përmbushur rregullisht, pra numri i profesionistëve të punësuar rritet në periudhën e monitorimit 2021-2022. Një rritje e mëtejshme e numrit të profesionistëve të punësuar do të rritej me miratimin përfundimtar të ndryshimeve ligjore në (LES, KP, LPP dhe Ligjin për Probacion) dhe duke rritur numrin e lëndëve të probacionit.

Rezultati 3.2. Krijimi i një qendre trajnimi dhe një buxheti për trajnimin e shërbimit të probacionit dhe për bashkëpunim me qendrat dhe akademitë e tjera përkatëse të trajnimit

Sa i përket Rezultatit - Krijimi i një qendre trajnimi dhe një buxheti për trajnimin e shërbimit të probacionit dhe për bashkëpunim me qendrat dhe akademitë e tjera përkatëse të trajnimit, në prill të vitit 2022 është zhvilluar një aktivitet me ekspertë nga Kroacia, me ndihmën e të cilëve janë përgatitur 4 dokumente: Vlerësimi i nevojave për trajnim dhe plani i zbatimit të trajnimit, Programi për trajnimin e trajnuesve, Kurrikula e trajnimit të brendshëm bazë dhe Hapi drejt së ardhmes – Forcimi i kapaciteteve që janë pjesë e qëllimeve strategjike të DES. Qendra e trajnimit të DES-it është krijuar dhe është vënë në dispozicion për realizimin e trajnimeve për punonjësit e sistemit penitenciar, ndër të cilët është edhe shërbimi i probacionit. Aktivitetet për emërimin e punonjësve në qendrën e shërbimit të probacionit, si dhe përgatitja e një plani të posaçëm buxhetor për qendrën e trajnimit, gjatë periudhës së monitorimit të Strategjisë, nuk janë realizuar ende.

Rezultati 3.3. Zhvillimi i një plani vjetor trajnimi për oficerët e probacionit që përditësohet rregullisht

Me qëllim të forcimit të kapaciteteve dhe aftësive të oficerëve të probacionit, Strategjia parashikon përgatitjen e një plani trajnimi vjetor nga DES-i. Në periudhën e monitorimit 2021 dhe 2022, këto aktivitete nuk kanë filluar ende me zbatim, pra në periudhën e monitorimit nuk është hartuar një plan vjetor trajnimi për oficerët e probacionit. Ky rezultat parashikon përgatitjen e planeve të trajnimit në nivel vjetor për punonjësit në sistemin penitenciar (punonjësit në DES, përfshirë shërbimin e probacionit, si dhe punonjësit në burgje), si dhe miratimin e një plani veprimi për zbatimin e trajnimeve.

Rezultati 3.4. Trajnimet e rregullta bazë do të zhvillohen për të gjithë oficerët e probacionit

Strategjia parasheh mbajtjen e trajnimeve bazë dhe trajnimeve speciale për oficerët e probacionit.

Nga gjithsej 28 oficerë të probacionit:

- 18 kanë kaluar 30 trajnime bazë për punën e oficerit të probacionit;
- 3 kanë përfunduar pjesërisht trajnimin bazë për punën e zyrtarit të probacionit;
- 14 zyrtarë iu nënshtruan trajnimit për aftësitë e komunikimit;

- 5 zyrtarë probacioni nuk kanë kaluar asnjë trajnim për punën e zyrtarit të probacionit (dy nga zyra e probacionit në Shkup, një nga zyra e probacionit në Kumanovë).

Në fushën e trajnimit për aftësitë e komunikimit, në grupin e punës së PR për marrëdhëniet me pumarrëdhëniet me publikun u përfshinë gjithsej 14 oficerë të probacionit, të cilët iu nënshtruan trajnimit bazë të komunikimit dhe nisën hartimin e strategjisë së komunikimit të shërbimit të probacionit.

Rezultati 3.5. Zhvillimi dhe përgatitja e trajnimeve speciale për lloje të veçanta klientësh

Përveç trajnimeve bazë, gjatë periudhës së monitorimit të Strategjisë, janë zhvilluar edhe trajnime për lloje të veçanta të klientëve, varësisht nga temat që zakonisht kryejnë nëpunësit e probacionit. Është planifikuar të zhvillohen trajnime për autorë të dhunës në familje, radikalizimit, punës me personat e varur nga droga dhe varësive të tjera si alkooli, bixhozi, kleptomania etj. Nga numri total i oficerëve të probacionit, 16 kanë kryer trajnime për njohjen e shenjave të radikalizimit. Ky lloj trajnimi është i paraparë me Strategji sepse karakteristikat specifike të veprave penale të këtij lloji kërkojnë aftësi dhe njohuri të veçanta të zyrtarëve të probacionit.

Rezultati 3.6. Trajnime të përbashkëta për krijimin dhe përmirësimin e bashkëpunimit të institucioneve përkatëse

Forcimi i bashkëpunimit dhe zgjerimi i njohurive është paraparë përmes mbajtjes së trajnimeve të përbashkëta me institucionet përkatëse.

